



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 129 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të fushatës zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga BIRN, me të cilën pretendohet se subjekti politik PDK, gjatë ditës së votimit, në largësinë prej 50 metrash nga qendra e votimit 2501/Y, përkatësisht në shkollën “Ahmet Hoxha”, janë vendosur posterë të kandidatit për kryetar komune të subjektit politik PDK- Agim Aliu. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2009 Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike të nenit 3, paragrafi 4.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi të posterit të kandidatit të subjektit politik PDK, për Kryetar Komune të Ferizajt, Agim Aliu.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar, pretendohet se në afërsi prej 50 metrash të QV 2501/Y, janë vendosur posterat e kandidatit të subjektit politik PDK, Agim Aliu, PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase provat e bashkangjitura në

ankesë nuk janë dëshmi të mjaftueshme, për të vërtetuar pretendimet ankimore, pasi që nga fotografia që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet objekti për të cilën pretendohet se ka qenë Qendër e Votimit (QV). Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 129/2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

